

**BASHKIA KOLONJË**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

*Data: 13 / 09 / 2016*

**Për: Mikael - Grup shpk**

**Adresa:** Libonik Vashtmi Korçë

**Procedura e prokurimit:** Procedura e Hapur “ PUNË ” me mjete elektronike .

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** “ NDËRTIM PUS UJI QYTETI LESKOVIK ”

**Burimi i financimit:** Vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë viti 2016 **Transferta e Pakushtëzuar , Grand .**

**Fondi limit pa TVSH: 4 833 333** (Katërmilionetetëqindetridhjetëetremijëetreqindetridhjetë etre) lekë pa tvsh.

Vlera e Financimit viti 2016 **4 833 333 lekë pa Tvsh**

**Afati për realizimin e shërbimit : 2 ( dy ) MUAJ nga nënshkrimi i kontratës .**

**Publikime të mëparshme :** Buletini i Njoftimeve Publike *DATA 01/08/2016 NR.30*

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

**Data e zhvillimit të tenderit/Hapja e ofertave:** 25 / 08 /2016, ora 11 : 00

**Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

**1. Operatori ekonomik** “ Boshnjaku.B ” sh.p.k

*Emri i plotë i shoqërisë*

**K 72627402 H**

*numri i NUIS-it*

Vlera e ofertës **4 325 630** ( Katërmilionetreqindenjëzetëepesëmijëegjashtëqindetridhjetë ) **lekë pa Tvsh.**

*(me numra dhe fjalë)*

**2.Operatori ekonomik** Joklen & Co shpk

*Emri i plotë i shoqërisë*

**K 84322601 F**

*numri i NUIS-it*

Vlera ( Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike ) **lekë pa Tvsh .**

*(me numra dhe fjalë)*

3. Operatori ekonomik “Mikael - Grup” sh.p.k  
*Emri i plotë i shoqërisë*

K 64108001 G  
*numri i NUIS-it*

Vlera e ofertës 4 776 000 ( Katërmilioneshtatëqindeshtatëdhjetëegjashtëmijë ) lekë pa Tvsh.  
*( me numra dhe fjalë )*

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1.Operatori ekonomik “ Boshnjaku.B ” sh.p.k ,  
*Emri i plotë i shoqërisë*

K 72627402 H  
*numri i NUIS-it*

2.Operatori ekonomik Joklen & Co shpk ,  
*Emri i plotë i shoqërisë*

K 84322601 F  
*numri i NUIS-it*

\* \* \*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1.Operatori Ekonomik “ Boshnjaku.B ” sh.p.k

a. Në shtojcën 10, kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.1**,kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

- a) Vërtetim lëshuar nga Bashkia Kolonje që operatori ekonomik nuk ka asnjë **detyrim kontraktual** të pashlyer pranë kësaj Bashkie.

Në dokumentet e tenderit nuk është kërkuar vërtetim në lidhje me detyrimet për ushtrimin e aktivitetit, por vërtetim që operatorët ekonomik nuk kanë asnjë **detyrim kontraktual** ndaj Bashkisë Kolonjë.

Deklarat juaj nuk meret në konsiderate pasi autoriteti kontraktor ju ka kthyer përgjigje duke ju pajisur me vertetimin përkatës me shkresë përcjellëse nr.2125 prot datë 19.08.2016.

b. Në shtojcën 10, kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3,pika 1** kapaciteti teknik kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

**1.Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

- a. **Pune të ngjashme** , per nje objekt te vetem me vlere jo me te vogël se **2 416 666** (Dymilionekatërqindegjashtëmbëdhjetëmijëegjashtëqindegjashtëdhjetëegjashtë ) leke pa t.v.sh të realizuar gjatë tre viteve të fundit; ose
- b. **Pune të ngjashme**, ku vlera monetare totale e puneve te kryera te marra se bashku gjate tre viteve të fundit është jo me të vogël se **9 666 666**( Nëntëmilionegjashtëqinde gjashtëdhjetëegjashtëmijëegjashtëqindegjashtëdhjetëegjashtë)leke pa t.v.sh .

## **Eksperienca në punë të ngjashme duhet të përfshijë punë shpime puse uji .**

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të operatorit ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Kopje kontrate

Aktin e kolaudimit,

Situacion Perfundimtar

Fatura tatimore te deklarimit te objektit ne organet tatimore

Formular vlersimi (sipas shtojces 8)

*Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik **Boshnjaku.B sh.p.k** ka dorëzuar kontratat si më poshtë :

- 1- Rehabilitimi i Rrjetit të Kanalit Ujitës të Rezervuarit Shishtavec .
- 2- Ndërtimi i Rrjetit të Kanalizimeve fshatrat Llakatund dhe Shushicë, Komuna Shushicë .
- 3- Ndërtim K.U.Z fshati VELMISH, Komuna Strum .
- 4- Ndërtim i Rrjetit të K.U.Z fshati Vajkan, Komuna Mbrostar, Fier .
- 5- Rikonstruksion i Rrugës “Goras-Aranitas” Faza e Parë, Komuna Selitë , Mallakastër .
- 6- Sistem-Asfaltim i Rrugëve fshati Lazaren, Komuna Pajovë, Peqin .
- 7- Rikonstruksion i Rrugës Topojë-Shën Pjetër, Komuna Topojë-Seman, Fier .
- 8- Rikonstruksion i Rrugëve të Brëndshme në lagjet Zaçaj dhe Isufaj, fshati Drenovë e Re, Bashkia Mallakastër .
- 9- Rehabilitimi i linjës së dërgimit të Ujësjetllësit qëndra e banuar DUSHK, Komuna Dushk, Lushnjë e lidhur në datë. 13.09.2014 midis Autoritetit Kontraktor Komuna Dushk Lushnjë dhe operatorit ekonomik Boshnjaku B sh.p.k .

Sa mësipër kontratat e dorëzuara **nuk janë të ngjashme** me objektin që prokurohet dhe për këtë arsye nuk vërtetohet eksperienca në punë e subjektit **Boshnjaku.B sh.p.k** .

Ndërsa kontratat si mëposhtë vijon :

1. **Ndërtim Ujësjetllësi fshati Algjinaj** e lidhur në datë. 03.10.2012 midis Autoritetit Kontraktor Komuna Shezë dhe Kontraktorit bashkimi i operatorëve ekonomik Sinan & Lici shpk dhe Boshnjaku B sh.p.k .
2. **Furnizimi me Ujë i Qytetit të Roskovecit** e lidhur në datë. 02.10.2012 midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Roskovec dhe Kontraktorit bashkimi i operatorëve ekonomik Boshnjaku B sh.p.k dhe Glavenica sh.p.k .
3. **Ndërtim i Ujësjetllësit Kurjan** e lidhur në datë. 30.07.2013 midis Autoritetit Kontraktor Komuna Kurjan dhe Kontraktorit bashkimi i operatorëve ekonomik Boshnjaku B sh.p.k & Shkëlqimi 007 sh.p.k dhe B 93 sh.p.k .

Komisionit i vlerësimit të ofertave ndodhet përpara rastit të kontratave të lidhura me bashkim operatorësh dhe nuk mund të evidentohet se cila është **piesa** që ju si operator ekonomik pjesmarës në bashkëpunim keni realizuar.

Sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave e ka të pamundur të vlerësojë mbi vlerën e përmbushur nga operatori **Boshnjaku B sh.p.k** lidhur me ekzekutimin e këtyre kontratave.

Pra, dokumentacioni i dorëzuar nga ju nuk përmbush kriterin e kërkuar në dokumentat standarte të tenderit mbi përvojën në punë të ngjashme .

c. Në shtojcën 10, kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.4,pika 3,gërma a,b,c,d** kapaciteti profesional kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

**1-Të paraqesë certifikatat për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit:**

- a. Shoqëria duhet të paraqesë Certificate të menaxhimit të cilësise se punimeve **ISO 9001-2008 (e vlefshme)**. (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet të paraqese certifikaten Iso).
- b. Shoqëria duhet të paraqesë Certificate të menaxhimit dhe ndikimit në mjedis **ISO 14001-2004 (e vlefshme)**. (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet të paraqese certifikaten Iso).
- c. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë të menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë **OHSAS 18001-2007(e vlefshme)**(Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet të paraqese certifikaten Iso).
- d. Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **PASS 99 :2012 (e vlefshme)** (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet të paraqese certifikaten Iso).

Dokumentacion i paraqitur nga operatori ekonomik **Boshnjaku B sh.p.k**,konkretisht **certifikatat ISO** nuk janë të vlefshme pasi aktiviteti i tyre nuk është objekt i prokurimit .

d. Në shtojcën 10, kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.4,pika 4**, kapaciteti profesional kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës ( shtojca 9) .

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	PRONESIA	SASIA
1.	Eskavator me goma	ne pronesi ose me qera	cope 1
2.	Kamioncina me kapacitet mbajtes 1-3 ton	ne pronesi ose me qera	cope 1
3.	Autosonde e pajisur me kompresor 20-25 atm	ne pronesi ose me qera	cope 1
4.	<b>Shtanga Shpimi</b>	ne pronesi ose me qera	250 m
5.	<b>Elektropompë zhytëse</b>	ne pronesi ose me qera	cope 1
6.	Matës Nivelë Uji Dixhital(Te tregojë diagramën)	ne pronesi ose me qera	cope 1
7.	Prerëse Asfalti	ne pronesi ose me qera	cope 1
8.	Ngjeshëse Asfalti	ne pronesi ose me qera	cope 1
9.	Gjenerator (15-20 KË)	ne pronesi ose me qera	cope 1
10.	Saldatriçe		

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar mbi disponimin e mjeteve dhe paisje teknike sipas ( shtojcës 9 ) nga operatori ekonomik **Boshnjaku B sh.p.k** mungojnë paisjet teknike **Shtanga Shpimi 250 m dhe Elektropompa Zhytëse**.

Elektropompa e deklaruar në shtojcën 9 me dokumentacionin bashkëngjitur faturë nr. 11 datë 30.04.2013 nuk është e vlefshme pasi nuk evidentohet si elektropompë zhytëse.

Komisioni gjykon se plotësimi i kriterit të vecantë të kualifikimit në lidhje me provueshmërinë e kapaciteteve (makinerive) lidhet ngushtë me përmbushjen me sukses të kontratës .

Sa mësipër komisioni i vlerësimit të ofertave vendos që operatori **Boshnjaku B sh.p.k** nuk e përmbushur kriterin e vendosur në dokumentat e tenderit lidhur mbi disponimin e mjeteve dhe paisje teknike .

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika3 dhe 5,të Ligjit Nr.9643,datë 20.11.2006,“Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**Joklen & Co shpk** .

**K 84322601 F**

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NUIS-it*

\* \* \*

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

**1.Operatori Ekonomik “Joklen & Co” sh.p.k**

Çmimi total i ofertës **Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike** .

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria **“Joklen & Co” shpk** nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike si dhe kishte mungesë të plotë në të gjitha dokumentat ligjore, administrative, kualifikuese të përcaktuara në dokumentat e tenderit .

**Ka dorëzuar vetëm një dokument** ( Çertifikatën e Regjitrimit ).

Mungesa e ofertës ekonomike dhe dokumentacionit u konfirmua nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika3 dhe 5,të Ligjit Nr.9643,datë 20.11.2006,“Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **31 . 08 .2016**

Ankesa: **JO**

Brenda afatit ligjor për paraqitjen e ankesave, nuk paraqit asnjë ankesë.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **operatorin ekonomik [Mikael - Grup shpk]** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **[4 776 000 ( Katërmilione shtatëqindeshatëdhjetë egjashtëmijë ) lekë pa Tvsh ]** është identifikuar si oferta e **suksesshme**.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë

**Emri**                                **Bashkisë Kolonjë**  
**Adresa**                            **Sheshi “ Rilindja ”**  
**Tel/Fax**                            **+355 812 2 2225 ; +355 812 2 3173**  
**E-mail**                             **bashkia.kolonje@gmail.com**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **30(Tridhjetëditëve) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Procurement  
Albania